



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.07.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Raportimi i ministrit të Shtetit për Diasporën, zoti Pandeli Majko, në lidhje me projektligjet dhe aktet ligjore të ndërmarra nga Ministria e Shtetit për Diasporën, si dhe për vizitat në diasporë (feedback dhe shpenzimet)
2. Çështje të tjera

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Elona Hoxha, Andrea Marto, Vasilika Hysi, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Klajda Gjoshaj, Ervin Bushati, Xhemal Qefalia, Edmond Panariti, Evis Kushi, Ilir Xhakolli

Mungojnë:

Tritan Shehu, Nard Ndoka, Rudina Hajdari, Klevis Balliu, Eglantina Gjermani, Edi Paloka

Të ftuar:

Pandeli Majko- Ministër i Shtetit për Diasporën

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Jashtëm të datës 4 korrik 2018.

I ftuar është ministri për Diasporën, zoti Majko, i cili do të raportojë lidhur me projektligjet dhe aktet ligjore të ndërmarra nga Ministria e Shtetit për Diasporën, vizitat dhe kontaktet që ai ka pasur me përfaqësues të diasporës në vendet anembanë rruzullit, si edhe çështje të tjera që lidhen me veprimtarinë e tij që nga momenti që kjo ministri është krijuar dhe ministri Majko e drejton.

Faleminderit, zoti Ministër, edhe për raportimin e detajuar që paraprakisht keni sjellë, si dhe për të gjitha problematikat që mendoni se duhen ndarë në Komisionin e Jashtëm!

Fjala për ju!

Pandeli Majko – Ju faleminderit, zonja kryetare!

Ashtu siç kemi diskutuar për procesin e ligjvënies, së pari, dua të falënderoj të gjithë kolegët e Komisionit të Jashtëm për mënyrën se si kanë proceduar, sepse në eksperiencën time, kjo është një nga proceset më të shpejta për votimin e tri ligjeve në Kuvend.

Sot kam ardhur t'ju raportoj për përmbylljen e fazës së parë, edhe në funksion të miratimit të tri ligjeve, që kanë të bëjë me ndërtimin për herë të parë të strukturës shtetërore për diasporën, reformën legjislativë, strategjinë kombëtare për diasporën dhe planin e veprimit, i cili ka kaluar me vendim të posaçëm të qeverisë për vitet 2018-2024. Kam sjellë një informacion për hapat e parë të organizimit të samitit të dytë të diasporës shqiptare, që do të organizohet në nëntor të këtij viti.

Gjithashtu, e mendova shumë të rëndësishme të depozitoj pranë jush edhe informacionin që i kam dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore për votimin e shtetasve të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit.

Gjithashtu, kam paraqitur një raportim të shkurtër rreth vizitave dhe pasqyrave financiare të shpenzimeve në këto vizita.

Kjo që unë po ju paraqes është struktura shtetërore, e cila aktualisht do të funksionojë mbi bazën e tri ligjeve. Pra, nuk do të jetë një strukturë, që do të funksionojë sipas një dëshire të mirë, por një strukturë që do të funksionojë sipas legjislacionit të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Siç e shikoni, në krahun këtej është Kuvendi, varësia që ka me nënkomsionin brenda Komisionit të Jashtëm, i cili është krijuar me vendim të posaçëm të parlamentit, ndërsa në krahun e ekzekutivit është Komiteti Shtetëror për Diasporën. Agjencia Kombëtare e Diasporës është krijuar me ligj të veçantë dhe do të ketë një marrëdhënie të veçantë me Këshillin Koordinativ të Diasporës.

Gjithashtu është qendra e votimeve për diasporën dhe Fondi i Zhvillimit të Diasporës, pra ligji i fundit që kaloi, që do të ketë marrëdhënie ndihmuese me dhomën e biznesit të diasporës. Në përgjithësi, e gjithë puna që do të jetë në vazhdim, do të ketë të bëjë me strukturimin apo edhe me ecurinë e kësaj skeme. Besoj se është një punë e përbashkët, të cilën ne e kemi diskutuar dhe vlen ta ripërsëris, se para disa muajve kjo ishte zero, nuk ekzistonte. Është një punë e përbashkët, për të cilën mendova se Komisioni i Jashtëm, por jo vetëm Komisioni i Jashtëm, edhe Kuvendi, nëpërmjet rezolutës, që do ta diskutojmë është e natyrshme që puna të ndihet në nivelin më të mirë të fjalës.

Reforma legjislative është duke ecur, ashtu siç ju thashë, duke filluar që nga vendimi për krijimin e Nënkomisionit për Migracionin dhe Diasporën pranë Komisionit të Jashtëm të Kuvendit. Është vendim i veçantë që u mor nga qeveria për krijimin dhe funksionimin e Komiteti Shtetëror për diasporën, është dhe vendimi për përcaktimin e fushës të përgjegjësisë shtetërore i ministrit të Shtetit për Diasporën, por këto kini parasysh që janë vetëm fillime. Më pas janë tri ligjet bazë fundamentale të politikës shtetërore, që është ligji “Për diasporën”, ligji “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” dhe ligji “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”. Kemi filluar punën me vendime, aktet ligjore të këtyre që do të prodhojnë këto tri ligje, të miratuara nga Kuvendi Shqipërisë; është miratuar vendimi nr. 114 “Për përcaktimin e rregullave për lajmërimin, shkarkimin dhe shpërblimin e kryetarit dhe anëtarit të këshillit drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës”; është miratuar vendimi nr. 340 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kushtet dhe mënyrën e përzgjedhjes së përfaqësuesve të këshillit koordinues të diasporës”; është miratuar vendimi nr. 339 “Për kriteret dhe mënyrën e ndarjes së çmimit të ambasadorit të kombit”, mbi bazën e këtij çmimi do të krijohet rrjeti ambasadorëve të kombit, që do të ketë marrëdhënie të veçantë me këshillin koordinativ të diasporës.

Gjithashtu është rregulli nr. 231 “Për përbërjen e detyrave sekrete teknik për komitetin shtetëror për diasporën”.

Paralelisht kemi ecur me marrëveshjen, e kemi nisur fillimisht me marrëdhëniet shtetërore. Prioriteti ynë ka qenë bashkëpunimi me shtetin e Kosovës; kemi marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë të Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në fushën e diasporës që është marrëveshja bazë. Më pas kemi firmosur edhe një marrëveshje tjetër, në nivel kryeministrash, që është marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë të Republikës së Kosovës për qendrat kulturore të diasporës. Sipas kësaj marrëveshje të dy shtetet

do të marrin bashkëpërgjegjësinë për krijimin e qendrave kulturore të diasporës, duke ndarë përgjysmë shpenzimet në çdo drejtim.

Gjithashtu kemi punuar edhe me fqinjët e tjerë, duke filluar nga fqinji ynë më i afërt, Maqedonia; kemi bërë deklaratë të përbashkët me të tre ministrat e diasporës: të Kosovës, të Shqipërisë dhe Maqedonisë dhe jemi duke negociuar marrëveshjen me Maqedoninë dhe Malin e Zi. Nga informacioni që unë kam këshilli i ministrave të Maqedonisë e ka kaluar draftin e marrëveshjes dhe është vetëm çështje firmosjeje, kurse me Malin e Zi edhe dje në takimin që patëm në Shkodër, e diskutuam, besoj se do të procedojmë, sepse e kemi depozituar draftin pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme, dhe më pas për të proceduar me firmosjen në një moment më të përshtatshëm.

Gjithashtu kemi firmosur disa memorandume mirëkuptimi, të cilat ne i konsiderojmë të rëndësishme, po i marr sipas radhës. Memorandumi i mirëkuptimit midis ministrit të Shtetit për Diasporën të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Kryqit të Kuq Shqiptar. Ne nuk duam të merremi vetëm me atë që quhet pjesë e suksesshme e diasporës, sepse nuk e konsiderojmë vetëm atë pjesë të diasporës, por edhe njerëz, që, për shumë arsye, ndodhen në kushte të vështira, siç është ajo e humbjes së lirisë.

Gjithashtu firmosëm memorandum mirëkuptimi me ministrin të Shtetit për Diasporës, me ministrin e Financave dhe Ekonomisë dhe me Guvernatorin Bankës së Shqipërisë. Kemi rënë dakord që çdo vit për çështjen e renimitancave do të bëhet një takim nën ombrellën e Bankës së Shqipërisë, pasi mendojmë se edhe në këtë fushë eksperiencia është goxha e rëndësishme për t'u diskutuar, aq sa ajo ekziston, dhe për të ridiskutuar në mënyrë permanente çdo vit në institucionin më të rëndësishme monetar të vendit, edhe llojet e shërbimeve, problematikat që ndeshim, bashkëpunimin me sistemin bankar, sidomos atë privat.

Për sa i përket çështjes së renimitancave, mjafton të thuhet se renimitancat sot që flasim, përfaqësojnë masën më të madhe të parave që vijnë përtej çdolloj ndihme apo investimi të institucioneve ndërkombëtare apo të privatëve që vijnë për interesat e tyre si investitorë të mëdhenj në Shqipëri. Kemi firmosur një memorandum të veçantë me organizatën “Germin”, pasi mendojmë se është një ndër organizatat më të specializuara për sa i përket bashkëpunimit në fushën e diasporës. Kjo nuk do të thotë se ne do të qëndrojmë këtu, por jemi të hapur për të bashkëpunuar edhe me organizata të tjera, pasi qëllimet që kemi, bazuar në Strategjinë Kombëtare dhe në Planin e Veprimit 2018-2024, kanë të bëjnë me nxitjen e bashkëpunimit me shoqërinë civile për çështjen e diasporës.

Ju kemi bashkëngjitur një informacion për aktet dhe memorandumet që janë në proces. Ashtu siç ju thashë, në proces janë: marrëveshja me qeverinë e Republikës së Maqedonisë;

projektvendimi për krijimin dhe funksionimin e qendrave kulturore të diasporës, të cilat i kemi çuar për mendim nëpër ministri dhe një memorandum bashkëpunimi për dhënien fund pashtetësisë, që e kemi bërë në bashkëpunim me zyrën e EMCR-së në Tiranë. Ky është një problem jashtëzakonisht i rëndësishëm, sidomos për fëmijët e emigrantëve, të cilët për arsye të ndryshme i kanë fëmijët të paregjistruar.

Akt dhe memorandum në proces është edhe ai që ju thashë pak më parë. Dua të nënvizoj dy elemente që kanë të bëjnë me krijimin e dhomës së biznesit në Itali dhe në Greqi. Për këtë arsye kemi depozituar dhe jemi në proces, duke bashkëpunuar edhe me zyrat tona diplomatike, për memorandumin e mirëkuptimit midis ministrit të Shtetit për Diasporën, ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Dhomës së Biznesit në Itali dhe Dhomës së Biznesit në Greqi. Kemi në proces një memorandum bashkëpunimi me rajonin e Sicilisë, ku kemi të vendosura shumë komunitete të rëndësishme jo vetëm të shqiptarëve të rinj, pra pas viteve '90, por sidomos të atyre arbëreshë. Po ashtu, kemi një projektvendim për regjistrimin e të dhënave të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës, që janë në proces në institucione të ndryshme.

Sigurisht, nuk mund të lë pa përmendur si informacion për komisionin faktin se në datën 09.05.2018, në vazhdim të atij diskutimi mjaft të rëndësishëm që ne bëmë në Kryesinë e Kuvendit vitin e kaluar së bashku me Kryeministrin dhe me përfaqësues të shoqërisë dhe të trupës ndërkombëtare, është miratuar me VKM-në nr. 259 Strategjia Kombëtare për Diasporën dhe Plan i Veprimit, duke detajuar sipas ministrive të gjitha detyrat, masat, sepse janë rreth 72 masa të ndara me përgjegjësi sipas ministrive, të cilat ne jemi duke i ndjekur hap pas hapi dhe nuk janë vetëm për vitin 2018, por edhe për vitin 2024.

Kam depozituar te ju Strategjinë dhe Planin e Veprimit, por në mënyrë të veçantë masat që do të ndiqen në vitin 2018, pasi fillimi është mjaft i rëndësishëm, sepse siç thuhet “fillimi i mbarë, gjysma e punës”. Plan i Veprimit dhe masat sipas institucioneve për periudhën 2018 përfshijnë një gamë shumë të gjerë institucionesh, duke filluar nga zëvendëskryeministrja, Akademia e Shkencave, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Instituti i Statistikave, Ministria e Arsimit, Ministria e Brendshme, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Kulturës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Shtetit për Diasporën, Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. E paraqita këtë informacion jo thjesht në kuptimin statistikor, por për të treguar se sa shumëplanëshe duhet të jetë Strategjia dhe se të trajnuar duhet të jemi ne që të ecim në një

drejtim të gjithë së bashku për të prodhuar atë që do të jetë politika e re shtetërore, në bazë të tri ligjeve që ka kaluar parlamenti shqiptar, në respekt të Kushtetutës.

Ndërkaq, kemi filluar përgatitjet për samitin e dytë të diasporës shqiptare që do të zhvillohet në datat 26-28 nëntor. Në program jua kam vënë datat 14-16 nëntor, por e ndryshuam, duke diskutuar edhe brenda qeverisë dhe mendoj se janë data goxha të gjetura. Do të ketë disa panele: për zhvillimin ekonomik dhe social; për agroturizimin; për identitetin kombëtar dhe për kulturën në diasporën; për gjuhën dhe arsimin; për diplomacinë dhe organizimin komunitar; për gjeneratat e së ardhmes etj; universitetet për kërkimin dhe zhvillimin dhe në fund fare konkluzionet dhe diaspora si cilësi kombëtare.

Ne kemi depozituar urdhrin për ngritjen e grupit të punës për vendimin për shpenzimet. Shpresoj se do të firmoset shumë shpejt nga Kryeministri dhe do të prodhojë aktin për sa i përket financimit të aktivitetit. Presupozohet të jetë një pjesëmarrje prej rreth 750 vetash. Nuk do të jetë një aktivitet i mbyllur, por një aktivitet i hapur, duke pasur parasysh se salla e Pallatit të Kongreseve mban 2200 persona. Por ajo do të konsideroja më të rëndësishëm faktin që do t'i mbledhim në një sallë të madhe siç është Pallati i Kongreseve por e fillova duke ju thënë angazhimin në 7 panele. Në çdo panel ashtu siç ju kam dërguar informacionin, çdo ministri, çdo institucion do të kenë pjesëmarrjen e tyre, angazhimet e tyre, me qëllim që të jenë panele diskutimi të rëndësishëm dhe me konkluzione që do t'u dedikohet edhe paneli 7, siç i kemi shprehur.

E mendova shumë të rëndësishme të informoj Komisionin e Jashtëm edhe për informacionin zyrtar që kam dërguar, i cili nuk është një opinion, por është një informacion i plotë të paktën për të gjithë eksperiencat që ekzistojnë për sa i përket votimit të shtetasve jashtë vendit, pasi i takon këtij komisioni të marrë vendim lidhur me këtë çështje. Ajo që për mua është jashtëzakonisht pozitive është se të gjitha palët në komision janë shprehur për votimin e shtetasve të Republikës së Shqipërisë. E mendova si shumë të rëndësishme që edhe Komisioni i Jashtëm, edhe nënkomisioni për Diasporën dhe Migracionin edhe në funksion të miratimit të rezolutës ky dokument të ishte i depozituar pranë Komisionit për Politikën e Jashtme.

Mendoj që çështja e vizitave të mos jetë një histori rutinë, por të jetë një histori e detajuar, për të cilën ministri i Shtetit duhet të japë llogari, jo vetëm në Komisionin e Politikës së Jashtme, por edhe në Komitetin Shtetëror për Diasporën, duke filluar që nga arsyet e vizitës, kush është kontaktuar, pse është kontaktuar, si dhe shpenzimet. Këto historitë e shpenzimeve janë nganjëherë më të ndjeshme sesa vizitat, nuk janë vizita turistike, por janë vizita për punë dhe në funksion të organizimit më të mirë të politikës shtetërore për diasporën.

Të nderuar kolegë, këto ishin me pak fjalë informacionet që dëshiroja të ndaja me ju, pas miratimit, po e përsëris me shumë respekt dhe falënderim për 3 projektligjet, në një kohë rekord për eksperiencat e mëparshme të parlamentit.

Falë kësaj ne sot kemi një strukturë shtetërore, e cila do të prodhojë në vazhdim një politikë të re shtetërore për diasporën.

Jam i hapur për çdo pyetje dhe sugjerim.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Ministër, edhe për punën, edhe për seriozitetin me të cilin e prezantoni çfarë është bërë deri tani.

Unë kam 2 pyetje. E ndoqa me vëmendje prezantimin tuaj, nëse e kam shënuar gabim, ka një VKM nr. 339, e cila flet për titullin “Ambasador i Kombit”. Rri mirë iniciativa dhe titulli, por desha t’ju pyes se cili është autoriteti që emeton këtë medalje? A ka kriter brenda VKM-së, nëse janë përcaktuar edhe kriteret se kush do ta përfitojë këtë medalje apo titull?

E dyta, pashë me vëmendje memorandumet e marrëveshjeve që ju keni firmosur ose keni në plan të bëni me organizma të ndryshëm. Ndoshta gaboj, nuk e di nëse ka një memorandum me Ministrinë e Arsimit nëse ka një të tillë, unë do të doja të kërkoja prej jush besoj se këtu po flas në emër të të gjithë komisionit që kjo marrëveshje të ishte, nëse nuk është, duhet të jetë pak e veçantë nga marrëveshjet e tjera, sepse mendoj që Ministria e Arsimit është absolutisht ministria çelës përtej tuajës në rritjen cilësore të Diasporës, në rruajtjen e gjuhës, traditës, historisë, pra është shumë domethënëse dhe është një strukturë çelës në mënyrë që të mos mund të vdesin me kalimin e viteve.

Këto ishin dy pyetjet e mia. Zoti Ministër, unë besoj se, nëse ka pyetje nga kolegët dhe më pas ju jepni nganjë përgjigje.

(Incizim i dobët)

Evis Kushi – Kam një pyetje të shkurtër, duke falënderuar ministrin për prezantimin. Para pak kohësh miratuam ngritjen e dy strukturave të reja, njëra prej të cilave është Agjencia e Diasporës, ndërsa tjetra Fondi i Diasporës.

Desha të dija nëse ka filluar puna për ngritjen e këtyre dy strukturave, si po ecën, dhe kur parashikohet se këto do të jenë plotësisht funksionale.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Zoti Ministër!

Pandeli Majko – Ka ndonjë pyetje tjetër?

Mimi Kodheli – Jo, ka komente.

Pandeli Majko – (Për sa i përket VKM-së nr. 339, në mos gaboj, për sa i përket titullit “Ambasador i Kombit” ky titull jepet nga Kryeministri i Shqipërisë. Propozimi vjen nga njeriu,

që në emër të shtetit shqiptar, njeh komunitetin shqiptar atje, ose që presupozohet e njeh më mirë, që është kreu i diplomacisë sonë atje, domethënë ambasadori. Pastaj propozimi shkon në Ministrinë e Jashtme, e më pas vjen te zyra e ministrit përgjegjës për Diasporën. Nuk është titull që ne do ta japim, po themi, ndonjë përfitim financiar. Ne kemi shumë njerëz, të cilët, pavarësisht se janë ose nuk janë (dhe unë tek kjo e dyta dua të ndalem) për shumë arsye, të aktivitetit të tyre apo të ngarkesës së punës së tyre jashtë vendit, janë ose nuk janë të angazhuar në strukturat tona organizative të diasporës. Ama, puna e tyre, suksesi i tyre reflekton te emri i Shqipërisë, reflekton te mënyra se si na shikojnë të tjerët, dhe del se ata e kanë fituar këtë titull edhe pse nuk e ka firmosur ndokush. Sidomos kam parasysh njerëzit e artit, njerëzit e kulturës, me të cilët kemi pasur sukses jo të pakët. Kjo nuk do të thotë se nuk kemi pasur sukses me të tjerët apo që nuk janë të suksesshëm njerëzit, të cilët janë duke bërë një punë të jashtëzakonshme me organizatat apo me organizimet e diasporës ekzistuese.

Për sa i përket memorandumit me Ministrinë e Arsimit, ne jemi duke bashkëpunuar me Ministrinë e Arsimit në mënyrë jashtëzakonisht të veçantë. Po ta shikoni, edhe kur bëmë ligjin e Agjencisë edhe kur bëmë ligjin e Fondit por sidomos të agjencisë, Ministria e Arsimit është pothuajse e kudondodhur në strukturat që do të prodhojnë politikën shtetërore.

Ministria e Arsimit është e përfaqësuar deri te Qendra e Edukimit të Diasporës. Ministria e Arsimit do të jetë e përfaqësuar edhe në struktura të natyrave të tjera. Nuk më kujtohet tani për Fondin e Zhvillimit, por kam përshtypjen se po.

Ne po punojmë ngushtësisht edhe për ligjin, sepse, me sa duket, do të sillen ndryshime nga ana e Ministrisë së Arsimit për ligjin “Për arsimin”. Nga një nen, që ka qenë i shkruar aty për diasporën, ne shpresojmë se, edhe me ndihmën tuaj, do të kemi mundësi të diskutojmë ndryshime të tjera për sa i përket ligjit “Për arsimin” sepse, realisht, ndodhemi në një situatë, e cila, së pari është reflektuar nga Ministria e Arsimit me punën e saj.

Pa dashur të jem zëdhënës i Ministrisë së Arsimit, dëshiroj të them se është miratuar kurrikula e përbashkët midis Shqipërisë dhe Kosovës, pra kurrikula arsimore për brezin e fëmijëve që janë në migracion apo ata të diasporës, ndërsa tani ka filluar puna për realizimin e librave.

Ju do të më pyesni mua se cila është pika e dobët në gjithë këtë histori. Janë librat online. Ne e bëjmë shpërndarjen e librit me metodat e vjetra: bëjmë tenderin, i shtypim, dhe i shpërndajmë me makina, apo vijnë mësuesit e vetë, sidomos këta që janë më afër, nga Italia e Greqia, dhe i tërheqin. Shpeshherë, trupi ynë diplomatik ka dalë shpeshherë edhe jashtë kufijve të punës normale prej diplomatësh, dhe janë marrë me shpërndarje librash. Nëse do të kishim libra online, do të kishim shmangur këto probleme. Sipas statistikave që ekzistojnë, te brezi i

fëmijëve që kemi në diasporë, rreth 10 % e tyre frekuentojnë kurset e formësimit kulturor dhe të identitetit. Ky është një problem shumë shqetësues, sepse një pjesë e tyre, një pjesë e madhe, edhe për arsye distance; imagjinoni tani se ç'duhet të flasim për fëmijët që ndodhen nga Kanada, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës deri në Australi, pra janë 300 familje shqiptare, që ne mund t'i furnizojmë ata me libra. Ky problem nuk është një shqetësim, por është një emergjencë. Për momentin ne jemi kombi me më shumë njerëz jashtë vendit dhe kemi më pak libra të botuar për ta. Me gjithë respektin për botuesit shqiptarë unë kam një rezervë ta jashtëzakonshme për sa i përket librit *online*, sigurisht me konceptin dhe me justifikimin e ankerimit, por ankerimi është një problem dhe mësimi i fëmijëve është një tjetër problem.

Unë shpresoj që shumë shpejt ne t'i japim drejtim kësaj situatë, në bashkëpunim të ngushtë edhe më Ministrinë e Arsimit.

Pyetja se ku ndodhemi me krijimin e agjencisë dhe të fondit, agjencia, sot që jemi duke folur, është në fazën e dytë të bërjes së konkurseve, sepse të gjithë punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Diasporës janë me status të administratës publike, madje sot, në mos gaboj, niveli i specialistëve ka provimin me gojë.

Lidhur me Fondin, ne e kemi mbaruar strukturën dhe do ta konsultojmë edhe me DAP-in, në mënyrë që më pas ta sjellim në parlament për ta miratuar.

Kini parasysh që nga buxheti i miratuar i këtij viti kemi siguruar fond vetëm pagat e punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Diasporës. Më falni që nuk jua thashë, por ne nuk e kishim diskutuar ende ligjin "Për Agjencisë Kombëtare të Diasporës", ndaj, me mirëkuptimin e Ministrisë së Financave, kaluam vetëm fondin e pagave. Në vazhdim, duke përfutur edhe nga rasti që kryetarja e komisionit ka profesionin e financieres dhe të ekonomistes, si dhe do të kërkoja ndihmën e të gjithë kolegëve, ne duhet të mësohemi që fillimisht duhet të investojmë dhe më pas të kërkojmë të gjitha frytet e punës. Unë jam i bindur për sa i përket krijimit të dhomës së biznesit për diasporën, e cila supozohet të jetë jo një ishull, por të jetë linjë komunikuese me Prishtinën, me Shkupin, sepse edhe aty do të ketë dhoma të biznesit për diasporën për shqiptarët. Kjo do të kenë një mundësi shumë e madhe për sa i përket zhvillimit ekonomik të vendit dhe ecurisë së mëtejshme.

Ndërkaq, ne kemi depozituar pranë Ministrisë së Brendshme për opinion, sepse u takon atyre të japin opinionin kryesor për sa i përket këtij shqetësimi. Këshilla e tyre ishte që ne do ta kalojmë nga këshilli i pushtetarëve lokalë, sepse e kemi të përkufizuar që në strukturat e bashkive duhet të ketë një zyrë për diasporën. Pra, pa kaluar në diskutime, unë do të doja të kishim një qëllim, pastaj a do ta pranojmë apo nuk do ta pranojmë, ne nuk do të përpiqemi të

bëjmë rolin e atij që do të bëjë mirë, por që nuk e lënë të tjerët. Për fondin shpresoj që të ndihmojë ministri i Financave, sepse supozohet të kemi një rishikim të buxhetit.

Për më tepër, ne kemi kaluar në qeveri një plan dhe e kemi në fund të strategjisë. Ne kemi kaluar një projeksion për vitin buxhetor, pra me vendim qeverie, të parë edhe nga Ministria e Financave. Pra, kemi kaluar një projeksion si për agjencinë, si për fondin, ashtu edhe për qendrën e botimeve, duke vënë shpenzimet financiare për këtë vit buxhetor. Ndërkaq kemi çuar te zyra e Kryeministrit një urdhër për të ngritur grupin e punës me koordinatore, për të bërë buxhetimin e të gjitha masave të veprimit, me qëllim që të mos jemi krijuar në ecje e sipër, por të jemi të qartë se çfarë do të kërkojmë për këtë vit buxhetor, për vitin tjetër e kështu me radhë.

Mimi Kodheli - Faleminderit, zoti Ministër!

Duke pasur mirëkuptimin e zonjës Gjoshë, do të bëj një koment para se t'ia jap fjalën. Mendoj që problemi i lëvizjes së librit në shqip, sidomos atij për fëmijë, apo i mësimin të gjuhës shqipe është një grup që ka kosto transporti, edhe në Alaska po të jetë, transporti ekziston kështu që mund të çohet. Në momentin që ju bëni këtë koment, në fakt, libri i prekur me dorë vlen akoma më tepër sesa libri i lexuar në një Ipad. Kjo besoj do të thotë që unë jam e kohës së vjetër, kam një moshë të caktuar, por gjithsesi nuk do të doja të hiqja ndjesinë e kthimit të faqes së librit. Besoj se ka ende shumë për të bërë në këtë drejtim, shpresoj shumë që me ardhjen e disa rregullimeve apo amendimeve të projektligjit “Për arsimin e lartë dhe parashkollor”, të ketë ndryshime edhe në strukturën e ministrisë, sepse unë besoj që Ministria e Arsimit, duhet të ketë një departament të dedikuar për çështjet e arsimimit të shqiptarëve në diasporë. Ky është një sugjerim.

Nga ana tjetër, me kalimin e kohës ne duhet të jemi më të qartë dhe më prezent në Komisionin e Reformës së Kodit Zgjedhor, për të kuptuar, për të prekur dhe për të cekur një ndër problemet, që besoj se mund të jetë më i diskutueshmi në ndryshimin e Kodit Zgjedhor dhe që shpresoj rënien dakord mes palëve, që është votimi i njerëzve që jetojnë jashtë. Në Europë, ka forma të ndryshme, por ne jemi ndër vendet e pakta që nuk e kemi një ligj për të drejtën e diasporës për të votuar. Ka disa variante që ne mund t'i diskutojmë, t'i paraqesim dhe të japim mendimin tonë, por besoj që në vazhdim të ecim në këtë drejtim me një intensitet të caktuar për votimin e diasporës. Është shumë e rëndësishme, sepse zgjedhjet vijnë vitin tjetër dhe nuk e di nëse do të ishte një projekt pilot që ne ta realizojmë këtë për të gjithë Shqipërinë për zgjedhjet lokale. Gjithsesi, një hap cilësor dhe i rëndësishëm besoj se do të ishte në ndihmë të procesit të transparencës, prandaj unë mendoj se ju keni një rol kyç në këtë drejtim për të sjellë opinionet tuaja, sigurisht dhe për t'i diskutuar në këtë komision.

Fjalën e ka zonja Gjoshë.

Klajda Gjoshë – Doja t'ju falënderoja që jeni sot në Komisionin e Punëve të Jashtme, për të vazhduar raportimin për një çështje të rëndësishme, siç është ajo e votimit të diasporës. Do të kisha preferuar që strategjitë dhe prezantimet t'i kishim marrë pak më përpara, sepse i kanë sjell në komision në orën 11:50 të ditës së sotme dhe ka qenë e pamundur që ne të lexojmë me detaje strategjinë për diasporën, për të drejtuar pyetje edhe më konkrete, por edhe për të bërë komente më të rëndësishme sesa ato që mund të dalin në këtë tryezë.

Nga prezantimi juaj ajo çfarë ra në sy ishte një theksim shumë i veçantë tek organizimi i samiteve, të dhënia e çmimeve apo dhe marrëveshjet që keni lidhur me institucione të tjera. T'ju them të vërtetën, jo se nuk i vlerësoj, sepse ato patjetër që kanë rëndësinë e tyre, por nuk i shoh parësore, aq më tepër nëse do të ndalesha të pjesa e marrëveshjeve mes institucioneve dhe mes ministrive, ndërkohë që është detyrë e institucioneve shtetërore të bashkëpunojnë me njëra tjetrën pa pasur nevojë që të lidhin një marrëveshje dhe të harxhojnë kohën për të shkruar pafund marrëveshje të tilla. Është detyrë e kabinetit qeveritarë që të bashkëpunojë për të gjitha çështjet që janë parësore, për një çështje kaq delikate, siç është ajo e diasporës, e harruar tashmë prej kohësh.

Do të kisha dashur të diskutoja edhe në një komision të mëparshëm, por, fatkeqësisht, nuk kam pasur mundësinë, kur është diskutuar Agjencia Kombëtare e Diasporës. Kjo qeveri trumbetoi faktin se do të bëjmë reformë në administratën publike, se do të ulim numrin e burokratëve dhe numrin e atyre që marrin financat e taksapaguesve shqiptar, ndërkohë vazhdojmë të ngremë pa fund agjenci kombëtare, të cilat mbi çdo gjë tjetër kanë një kakofoni të madhe kompetencash mes institucioneve të këtij vendi, sidomos mes kompetencave që ka vetë Ministria e Punëve të Jashtme në Europë. Unë do të kisha dashur që financat, në vend që të shkonin për burokracitë, ashtu siç ka thënë edhe Kryeministri në fillim të këtij mandati, të shkonin aty ku me të vërtetë është dhimbja më e madhe e diasporës, të arsimit, ruajtja e gjuhës, tek ruajtja e kulturës, e traditës, sepse mbi të gjitha ata kanë më tepër nevojë për respekt nga shteti i tyre, se për një *shoë* kaq të madh dhënie çmimesh, dhënia ambasadori, më i mirë i diasporës. Patjetër këto, por të zgjidhim ato që janë parësore.

Unë mendoj që për këtë pjesë paguajnë më shumë, ndërsa jetën e tyre janë munduar ta zgjidhin në ato vende që ata zgjedhin të jetojnë me punën e tyre, me dinjitetin e tyre.

Unë mendoj se shteti shqiptar duhet të jetë shumë herë më i fokusuar te këto çështje se tek ato që në sipërfaqe mund të ngjajnë shumë të bukura, por në thelb nuk e prekin diasporën shqiptare.

Faleminderit!

Pandeli Majko – Unë i vlerësoj të gjitha komentet e ministres, por mendoj se do të ishte e tepruar nëse unë do të vija për paradë samitesh.

Unë mendoj se ne jemi duke ndërtuar një strukturë shtetërore sa i përket diasporës. Mjafton të thuhet se më përpara në shtetin shqiptar ishin tre vetë që merreshin me çështjen e diasporës, kurse sot ne kemi një strukturë, e cila edhe nga pikëpamja ligjore, gjithsecili e di çfarë bën dhe ku, duke filluar me dokumentet kryesore, siç është strategjia dhe elemente të natyrave të tjera, të cilat ishin inekzistente. Shqipëria nuk ka pasur ndonjëherë strukturë për diasporën.

Çështja e respektit pastaj është një moment subjektiv, të cilin ne mund ta diskutojmë, por mendoj se nuk do të biem dakord pasi respekti ka një ngjyrë të ndryshme te çdo individ.

Unë mendoj se është shumë e rëndësishme që sot që flasim shteti shqiptar do të ketë me ligj një këshill koordinativ, i cili, kur të kërkohet, dhe jam i bindur se do të kërkohet më shpesh se sa mendojmë ne në tavolinë, do të drejtohet nga vetë Presidenti i Republikës, përfaqësuesit e diasporës do të jenë krah për krah me drejtuesit më të rëndësishëm të shtetit shqiptar. Ky nuk është respekt, ky është një konceptim i ri i marrëdhënieve me njerëzit, të cilët nuk i kemi këtu.

Pasi nuk mund të pranojmë që kemi shpesh një patologji edhe në administratën tonë të nderuar e cila ka...të bërjes së politikës, i trajton njerëzit tonë jashtë si njerëz që nuk paguajnë taksa dhe nuk kanë pse të merrem aq shumë me ta. Kështu që falë një angazhimi të përbashkët të qeverisë, Kuvendit dhe institucioneve të tjera, unë do ta kundërshtoja faktin pse faktin pse bëhen këto memorandume. Memorandumet bëhen për tema të rëndësishme.

Çështja e shtetësisë është që kërkesë që ne na u kërkuar nga zyra e UNCHR-së dhe po ju them se shumë nga ata, të cilët ishim në tavolinë u ndjenë jo mirë, me faktin që ne kemi qindra fëmijë dhe nuk e dimë këtë. Memorandumi, që ende nuk është firmosur, sipas meje, është shumë i rëndësishëm.

Ne kemi tema të tjera që kërkojnë vëmendje siç është çështja e të burgosurve jashtë vendit. Shqipëria ka më shumë të burgosur jashtë vendit se brenda vendit. Ne na duhet një koordinim shumë institucional, edhe një psikologji e re bashkëpunimi, sepse për një pjesë të mënyrës si kanë funksionuar administratat tona ne mendojmë se të burgosur janë vetëm ata që janë brenda Shqipërisë. Me ata që janë jashtë nuk ka kush merret. Ndërkohë që nuk është kështu.

Prandaj gjëra të tilla ishte shumë e rëndësishme për t'u diskutuar si informacione në këtë takim sot.

Mendoj që samiti është një ngjarje shumë e rëndësishme, e cila do të bëhet normalitet dhe që unë shpresoj të paktën në një të ardhme të mos jetë vetëm një koncept organizativ shtetëror, por të jetë vetë diaspora ajo që do ta bëjë këtë.

Gjithsesi ne jemi në hapat e para të organizimit të një strukture shtetërore, e cila shumë shpejt, jam i bindur që do ta thotë këtë. Shteti shqiptar nëpërmjet ndryshimeve legjislative dhe krijimit të strukturës shtetërore që ju informova sot, po u thotë njerëzve tanë që ne po bëhemi gati t'i përgjigjemi nivelit të ri të marrëdhënies me atë që e quajmë diaspora e Shqipërisë dhe diaspora shqiptare.

Klajda Gjoshaj - Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Ministër, për prezantimin e detajuar!

Në lidhje me punën e bërë nga Ministria e Diasporës, të them të vërtetën është një prezantim dinjitoz i gjithë punës së bërë nga ministria që ju drejtoni.

Kisha disa komente dhe sugjerime në lidhje me punën e ministrisë suaj, duke vlerësuar, në radhë të parë...që me rastin e vitit të Skënderbeut, ne tashmë do të kemi një samit të dytë të diasporës shqiptare. Besoj se ndoshta do të kemi edhe një komunikim tjetër përpara këtij samiti për të dhënë edhe ne mendimet tona, apo në funksion të mirorganizimit të tij.

Kam një merak për sa i përket ligjit për shtetësinë, se nuk e di si ka vazhduar puna në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme. Në dijeninë time është një ligj shumë i vjetër që i përket vitit 1999 dhe puna e deritanishme ka treguar që ka boshllëqe, të cilat jam e bindur që prekin edhe bashkëkombasit tanë.

Po ashtu kisha një pyetje në lidhje me marrëveshjen në fushën e sigurimeve. Gjatë këtij vitit të parë të legjislaturës kemi miratuar disa marrëveshje në fushën e sigurimeve, por mendoj se duhet një hap më i shpejtë në vendet ku ne kemi shtetas shqiptarë më shumë, flas për Italinë apo Greqinë. Kjo do të jetë në ndihmë të realizimit të interesave të shqiptarëve që jetojnë jashtë Shqipërisë.

Kam edhe një pyetje për sa i përket *data base*-it për shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë Shqipërisë. A keni tashmë një *data base* të përpiluar nga ministria juaj në lidhje me këtë? Nëse ka, kjo gjë mund të komentohet.

Së fundi, kam edhe një pyetje për kryetarin e nënkomisionit të diasporës, zotin Shameti. Tashmë është miratuar Nënkomisioni për Diasporën dhe Migracionin, nuk e di çfarë planesh ka nga vetë anëtarët, por kërkojmë shpejtësi të punës, pasi edhe vet përkufizimi i nënkomisionit është diaspora dhe migracioni, kështu që shpresoj që të

Ju faleminderit!

Mimi Kodheli - Profesor, fjala për ju!

Edmond Panariti – Faleminderit, zonja kryetare!

Falënderoj zotin Ministër për paraqitjen komplekse të strategjisë dhe rolit të ministrisë që ai drejton në tërheqjen e interesit të diasporës dhe bërjen e saj pjesëmarrëse në zhvillimin ekonomik, social-kulturor të vendit, kështu që pa dyshim është për t'u përshëndetur.

Në këndvështrimin tim roli i Ministrisë së Diasporës është dhe do të jetë më tepër një rol katalizator i interesit dhe pastaj strukturat e tjera ekzekutive të qeverisë shqiptare, të cilat do të mund të detajojnë dhe mund të vënë në lëvizje interesin që ka për detyrë të kanalizojë këtë ministri.

Ky është koncept i ri për Ministrinë e Diasporës, prandaj kjo paraqitje kaq e ngarkuar është për t'u përshëndetur dhe mendoj se është tepër e madhe për shpatullat e kësaj ministrie, aq më tepër që ndodhemi përpara rrezikut për të pasur përplasje me ministrinë e linjës.

Ndërkohë, ndaj të njëjtin mendim me zonjën Gjoshë, që për mua, ashtu siç e mendoj, më duket një nonsens institucional që qeveria e nënshkroi brenda saj marrëveshjen e bashkëpunimit kur është një organ në fjalë që e ka të presupozuar që ministrinë janë të detyruara të koordinojnë, bashkëpunojnë dhe nuk kanë nevojë të bëjnë memorandume. Në radhë të parë nuk është një marrëveshje ku ekziston një kuadër ku palët e angazhuara tregojmë vullnetin.

Efektivisht, qeveria është një organ kolegjal, që drejtohet nga Kryeministri, i cili më pas në funksion dhe drejt një qëllimi të caktuar ndan edhe rolet, që më pas bëhen konfirmuese të bashkëvepruese të Kryeministrisë.

Nga ana tjetër, vura re se në samit, pavarësisht se është një aktivitet i kaluar, por i cili na u prezantua këtu, u fut një problem specifik. Për shembull, samiti ka një panel për agroturizmin. Shumë mirë, por i takon Ministrisë së Bujqësisë praktikisht roli i interesit të diasporës, të investitorit, të cilët mund edhe të mos jenë primar por mund të jetë për prodhim primar, për prodhim blegtoral, mund të jetë për peshkim, por duhet të kanalizohet me Agjencinë e Investimeve të Huaja dhe më pas ministria e linjës, ndërkohë që ti e merr këtë atribut dhe e fut pjesë të një samiti, ndërkohë këtu ekziston një ngërç i madh.

Pra, ti vendos një temë dhe e fokuson atë kur interesi mund të jetë shumë më i madh, por ti e ngushton, sepse e bën pjesë të një paneli, të një samiti. Unë mendoj se roli i Ministrisë së Diasporës është thjesht organizator, identifikon, diagnostikon, zbulon interesin e diasporës, i promovon ato, pa dyshim elementi i promovimit është i rëndësishëm, i inkurajon dhe më pas ministria e linjës mund të themelojë interesat për t'i bërë ato instruktive, për t'i kthyer në investime, në zhvillime e të tjera.

Unë mendoj që edhe për këtë ministri është më mirë për t'u çliruar nga një barrë shumë e madhe, një mbingarkesë, superstrukturim dhe natyrisht ta çlironte këtë mbingarkesë edhe në

ministritë apo institucionet e tjera të linjës se si mund t’ia kalojmë ministrisë, sepse me të vërtetë është një punë goxha voluminoze. Mendoj se do të ishte më e eficiente që ministria që ai drejton të kishte një strukturë më të zhërvjellët, më të thjeshtë dhe shumë çështje që ajo i identifikon, i promovon dhe i tërheq t’i shkarkonte në pjesët e tjera të qeverisë shqiptare, të cilat janë të detyruara, sipas detyrave që kanë dikasteret përkatëse, t’i ekzekutojnë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Historia është pak, por mua më ngacmoi goxha, kuptohet duke e kuptuar edhe humorin e kolegut.

Nuk mendoj se kemi të bëjmë me një strukturë, e cila po bëhet me porosi për një ministër, pavarësisht se jemi duke folur për një strukturë të miratuar në funksion të diasporë. Po të shihni ligjin për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, agjencia nuk drejtohet, po e quaj kështu, nga politika e agjencisë, nga dëshira apo doktrina e ministrit përgjegjës për diasporën, por nga një këshill, i cili ka përfaqësues të ministrive kryesore në vend. Po të shihni Qendrën e Botimeve për Diasporën ajo drejtohet përsëri nga një këshill, i cili edhe në funksion të shqetësimit tuaj, ka përfaqësues të institucioneve kryesore që ndërlidhin punën për çështjen e diasporës pranë këtij këshilli edhe në fusha të tjera. Edhe në Fondin e Zhvillimit përsëri është një këshill me përfaqësues të institucioneve të tjera. Pse? Pikërisht kjo ka të bëjë me shqetësimin që ju ngritët, sepse rrezikohet që e gjithë kjo strukturë të kthehet në një xhep të izoluar nga veprimtaria e institucioneve të tjera të pavarura.

Edhe kur keni diskutuar projektligjin, këtë çështje e keni pasur goxha shqetësim, sepse kur iu drejtova edhe institucioneve që do të merren me zbatimin e strategjisë, ju kam thënë: shikoni sa është shtrirja duke filluar nga zëvendëskryeministri, Akademia, Agjencia, Instituti i Statistikave dhe më pas me radhë të gjithë ministrat e qeverisë, që kanë ndonjë peshë dhe pjesa më e madhe e tyre është brenda strukturave që do të konsiderohen fundamente të promovimit të politikës shtetërore për diasporën të miratuara me ligj. Nëse do të kishim një strukturë *ad hoc* për një ministër Shteti, ta quajmë kështu, që do të marrë përsipër gjëra që nuk i mbajnë shpatullat, besoj se ironia juaj nuk ishte me shumë vend. Duhet të kishte vend për goxha shqetësim dhe debat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kuptova.

Mendoj se qëllimi i të gjithë legjislacionit dhe i strategjisë është të kuptuarit, se ky është një proces shumëplanësh.

Pastaj, për sa i përket ligjit të çështjes së shtetësisë, me sa di unë, në Ministrinë e Brendshme ka filluar diskutimi dhe është ngritur grupi i punës për ndryshime në ligjin e shtetësisë.

Zhvillimi i memorandumëve për çështjen e pashtetësisë është se në disa vende ne kemi vakum ligjor dhe çështja e vakumit ligjor kërkon një bashkëpunim ndër-institucional, i cili duhet tejkaluar...

Pa diskutim, besoj se kur ne të kemi një ligj të ri për shtetësinë, proceset e pashtetësisë së bashku me UNHCR-në do të jenë drejt venitjes, sepse është ligj që prevalon.

Për sa i përket çështjes së të burgosurve, ne jemi të detyruar të fillojmë të mendojmë një mënyrë të re të sjelluri. Si fillim, kemi menduar një memorandum, pastaj në vazhdim do të shikojmë.

Për sa u përket remitancave, Shqipëria nuk ka eksperiencë, po jo vetëm Shqipëria, por pothuajse i gjithë rajoni. Nuk kemi një aktivitet, siç ndodh në zona të tjera të botës, ku bëhen aktivitete dhe marrin pjesë strukturat më të rëndësishme ndërkombëtare, duke filluar nga Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar e kështu me radhë, që diskutojnë çështjet e remitancave. Kjo është një nga të ardhurat më të jashtëzakonshme që diskuton sot bota. Janë rreth 400 milionë njerëz të cilët mbajnë, në mos gaboj, 1 miliard e gjysmë; persona me të ardhura që quhen remitanca. Domethënë, nuk është një gjë që nuk ekziston si eksperiencë, por te ne nuk ka të tilla ende.

Ne jemi detyruar t'i tejkalojmë këto edhe me këtë që, e pranoj, duke si ironike, ç'janë këto memorandumë për të bashkëpunuar institucionet, në një kohë kur ato do të funksionojnë mbi bazën e ligjeve në fuqi. Por për çështje dhe natyra problemesh të cilat janë risi, sa edhe ligji për to flet pak ose aspak, ne jemi të detyruar të ecim edhe kështu derisa të kemi atë që, siç e thashë, një ligj të ri për shtetësinë apo momente të natyrave të tjera, që ju apo kolegët e tjerë, me të drejtë, i ngritët si shqetësime.

Për sa i përket marrëveshjes në fushën e sigurimeve, Ministria për Europën dhe Punët me Jashtë së bashku me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave po punojnë sipas një *database*-i. Unë shpresoj që shumë shpejt të kemi nënshkrimin me Kanadanë, si dhe jemi duke mbyllur draftet me disa shtete të tjera. Edhe për interesin tuaj, mund të them se në disa raste ne kemi përfshirë edhe përfaqësues të nderuar të diasporës, që të bëhen pjesë e mekanizmit të diskutimit të këtyre marrëveshjeve për atë nivel organizimi që ekziston.

Për sa i përket *database*-it për diasporën, do të fillojmë me adresat dhe kemi një fat, sipas meje, që kompania koncesionare, që merret në vazhdim me përgatitjen e dokumenteve kryesore, ka një detyrim, që e ka detyrim të jetë edhe kontraktuale, për sa i përket shkrimit të

plotë të të gjithë adresarit dhe të gjitha detajeve të çdo individi që është brenda dhe jashtë vendit.

Një pjesë e këtyre gjërave për shumë arsye, ndoshta edhe nisur nga eksperiencia administrative që vinte nga pala shqiptare, kjo nuk është bërë në mënyrë rigoroze, por tani plotësohet afati dhjetëvjeçar i përdorimit të kartave të identitetit dhe i pasaportave shqiptare, në kuptimin që tani nuk mund të ketë më justifikime që dikush të vijë, për shembull, nga Franca apo nga Belgjika dhe, për të marrë një pasaportë apo kartë identiteti, të shkruajë në adresë të babait apo për jetën që ka pasur këtu në Shqipëri, së pari, sepse kjo është një gënjeshtër, dhe, së dyti, sepse kjo nuk ndihmon as atë vetë në një moment të dytë kur ne të diskutojmë, le të themi, të drejtën e votës e kështu njëfarë çështjesh të tjera që kanë të bëjnë me marrëdhënie më të konsoliduara ndërmjet shtetit shqiptar dhe komuniteteve shqiptare jashtë vendit.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Ministër!

Nëse nuk ka komente ose pyetje të tjera, unë dua që, edhe në emër të kolegëve, t'ju falënderoj, ndërkohë që dua realisht të falënderoj edhe kolegët, sidomos zonjën Gjoshë dhe zotin Panariti, **për** komentet konstruktive që kanë dhënë dhe japin në këtë komision, opinionet dhe diskutimet, gjithashtu.

Duke i rikujtuar gjithashtu kolegut Shameti se duhet të jetë më aktiv në organizimin e mbledhjeve të nënkomisionit, ndaj plotësisht të njëjtin opinion me kolegen Gjëbrea, sepse mendoj se do të kemi një intensifikim të gjithçkaje që do të vijë në komision, lidhur me tematikën dhe me risitë që ministria dhe nënkomisioni ka. Ndaj, mendoj se me seriozitetin që na karakterizon, të mundësojmë më të mirën, sigurisht, edhe në mbështetje edhe të ministrit, por së pari, në mbështetje të kërkesave të diasporës.

Edhe një herë, faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk është me votim.

Ndërkohë, ka një çështje që besoj se nuk është më pak e rëndësishme, pavarësisht se e përmendim në fund. Unë shpresoj të keni në dosjet tuaja një projektrezolutë mbi reformën e politikës shtetërore për diasporën. Mendoj se kjo rezolutë përmbledh shumëçka, që ne kemi bërë dhe kemi thënë deri tani, që nga momenti i krijimit të Ministrisë së Shtetit për Diasporën, te ligjet që kemi miratuar gjatë kësaj periudhe, qoftë ai për diasporën, qoftë ai për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, apo ligji për Fondin e Zhvillimit të Diasporës.

Kështu, mendoj se duhet t'i propozojmë Kuvendit të Shqipërisë, propozimet që vijnë nga ky komision dhe nga nënkomisioni, lidhur me miratimin e strategjisë kombëtare dhe dokumentacionin bashkëngjitur, të cilin të gjithë ne e kemi prezent. Ndaj, mendoj ta kalojmë

këtë projektrezolutë me shpresën që jo vetëm të kemi një rezolutë të zbatueshme, por që ky të jetë vetëm fillimi i një pune intensive për një çështje të rëndësishme siç është diaspora, siç tha edhe ish-ministrja Gjoshë, në një moment.

Klajda Gjoshë – Zonja kryetare,

Ne patjetër mund të kalojmë shumë projektrezoluta, por së pari duhet të na jepni kohën e mjaftueshme, që së pari, ta lexojmë projektrezolutën, të kuptojmë se çfarë shkruhet në të dhe, nëse anëtarët e komisionit kanë ndonjë sugjerim.

Mimi Kodheli – Dakord, patjetër.

Kërkesa juaj pranohet. Kështu, do të marrim kohën e mjaftueshme dhe ta shqyrtojmë në një mbledhje të dytë të komisionit. Mbetet në të drejtën tuaj për të bërë vërejtje.

Ne kemi lënë një mbledhje komisioni për nesër, ku do të diskutojmë dy çështje, dy projekt marrëveshje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë po them, do të mbledhemi nesër në ambientet e Kuvendit dhe do të kemi edhe një mbledhje për ditën e enjte.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht, gjatë këtyre ditëve, do të marrim kohën e mjaftueshme për ta parë.

Faleminderit!

Faleminderit, zoti Ministër!

MBYLLET MBLEDHJA